



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:247245

Datë: 04.07.2022

Numri i dokumentit: 03197390

E.nr.1/2013

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Sabaheta Kurteshi, duke vendosur në lëndën e përbarimore të kreditorit B. E., sh.a, me seli në Prishtinë Sheshi “ N. T.“ pa.nr, ndaj Debitorëve S.T.R. “N.“ , B. N. dhe B. N., nga fshati B., për shkak të borxhit ndaj kreditorit, më datë 04.07.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

Propozimi i kreditorit në këtë çështje përbarimore konsiderohet se është **TËRHEQUR.**

A r s y e t i m

Kreditori ka bërë propozimin për përbarim në bazë të marrëveshjes nr. 28843 të datës 04.05.2011 , marrëveshje e vërtetuar pran; Gjykatës Komunale në Dragash Vr.nr. 209/2011 të datës 11.05.2011 dhe ka propozuar kësaj gjykatë që të lejoj përbarimin për shkak të borxhit të debitorit ndaj kreditorit.

Gjykata Themelore në Dragash me aktvendim E.nr.1/13 të datës 04.01.2013, ka lejuar përbarimin.

Kreditori **B. E., sh.a, me seli në Prishtinë Sheshi “ N. T.“ pa.nr**, ka paraqitur parashtrësë për tërheqjen e propozimit për përbarim të parashtruar kësaj gjykate e i cili e ka tërhequr propozimin për përbarim kundër debitorëve.

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 43 par.1 të Ligjit për procedurën përbarimore Ligji Nr.04/L-1390 , dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2021:247245, 04.07.2022**

Gj y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar Ankesa.